



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 3

25 janar

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 7927 datë 15.1.2013	Për emërim gjyqtari 47
Dekret nr. 7929 datë 18.1.2013	Për emërim gjyqtari..... 47
Vendim i KM nr. 11, datë 14.1.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 140, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar 48
Vendim i KM nr. 12, datë 16.1.2013	Për kalimin në përdorim të Agjencisë së Prokurimit Publik të disa mjediseve në përdorim të Komisionit të Prokurimit Publik dhe kalimin në përdorim të Komisionit të Prokurimit Publik të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) së ish-INIMA-s 50
Vendim i KM nr. 17, datë 9.1.2013	Për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV Tirana 2, nënstationi 110 kV Kashar-Selitë 54
Vendim i KM nr. 18, datë 9.1.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 707, datë 25.8.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kV, Tiranë – Podgoricë, qarku Tiranë”, të ndryshuar 56
Vendim i KM nr. 20, datë 9.1.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Labinot - Mal të qarkut të Elbasanit... 59

Vendim i KM nr. 21, datë 9.1.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Rubik të qarkut të Lezhës	60
Vendim i KM nr. 22, datë 9.1.2013	Për disa shtesa në vendimin nr. 370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e misionit të Republikës së Shqipërisë pranë selisë së NATO-s, Bruksel”, të ndryshuar	62
Vendim i KM nr. 23, datë 9.1.2013	Për përcaktimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për periudhat 1 janar - 15 qershor 2013 dhe 15 shtator - 31 dhjetor 2013, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës	62
Vendim i KM nr. 24, datë 9.1.2013	Për miratimin e kuotave të pranimit dhe të tarifave të shkollimit, në programet e studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2012-2013.....	64
Vendim i KM nr. 25, datë 9.1.2013	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të pronave të paluajtshme shtetërore të bashkisë Tiranë	68
Vendim i KM nr. 26, datë 9.1.2013	Për miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe të kandidatit fitues për privatizimin e shoqërisë “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.....	70
Vendim i KM nr. 27, datë 9.1.2013	Për miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe të kandidatit fitues për privatizimin e shoqërisë “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a.....	74
Urdhër i MD nr. 2/1, datë 8.1.2013	Për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit....	77
Udhëzim i KMDHP nr. 33, datë 21.1.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 24.9.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj”.....	78
Udhëzim i KMDHP nr. 34, datë 21.1.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 22, datë 24.9.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël”.....	79

DEKRET
Nr. 7927, datë 15.1.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136 pika 4 të Kushtetutës, si dhe të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Evjeni Sinojmeri emërohet gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 7929, datë 18.1.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136 pika 4 të Kushtetutës, si dhe të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Valbona Vata emërohet gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



VENDIM
Nr. 11, datë 14.1.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 140, DATË 17.2.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SPITALORE NGA SKEMA E
DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 pika 2 shkronja “c” e 26 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 26 të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca nr. 2, bashkëlidhur vendimit nr. 140, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Buxheti per sherbimin spitalor per vitin 2013					Shtojca nr.2 (ne mije leke)		
Nr	Institucioni dytesor	Nr. Punonjeseve plan	Buxheti per vitin 2013				
			Paga,fond i vecante,kompe sime (600,606)	Sigurime shoq.shend (601)	602	rezerve e pashperndare	Buxhet total
1	Berat	411	226,000	37,000	153,000	0	416,000
2	Bulqize	105	56,000	9,200	24,000	0	89,200
3	Delvine	32	18,450	3,000	5,800	0	27,250
4	Devoll	57	33,200	5,400	16,300	0	54,900
5	Diber	383	202,100	33,000	129,000	0	364,100
6	Elbasan	657	354,000	58,000	182,000	0	594,000
7	Fier	526	283,100	46,400	354,000	0	683,500
8	Gramsh	164	94,500	15,500	42,850	0	152,850
9	Gjirokaster	260	145,500	24,000	112,000	0	281,500
10	Has	43	25,625	4,200	13,000	0	42,825
11	Kavaje	169	94,150	15,400	33,600	0	143,150
12	Kolonje	135	73,550	12,000	22,200	0	107,750
13	Korce	589	313,500	51,400	222,386	0	587,286
14	Kruje	177	101,000	16,500	33,600	0	151,100
15	Kucove	77	45,150	7,400	15,200	0	67,750
16	Kukes	323	174,200	28,500	81,000	0	283,700
17	Lac	99	54,800	9,000	26,850	0	90,650
18	Lezhe	283	155,750	25,500	95,000	0	276,250
19	Librazhd	209	118,900	19,500	45,500	0	183,900
20	Lushnje	312	173,000	28,400	106,000	0	307,400
21	Malesi e Madhe	17	11,480	1,900	5,300	0	18,680
22	Mallakaster	39	23,000	3,800	10,500	0	37,300
23	Mat	203	110,700	18,100	46,000	0	174,800
24	Mirdite	202	110,000	18,000	33,600	0	161,600
25	Peqin	30	18,450	2,750	10,500	0	31,700
26	Permet	134	74,300	12,200	26,000	0	112,500
27	Pogradec	255	143,700	23,500	71,500	0	238,700
28	Puke	155	83,800	13,700	36,500	0	134,000
29	Sarande	200	118,000	19,300	57,500	0	194,800
30	Skrapar	145	76,000	12,500	18,700	0	107,200
31	Shkoder	794	423,700	69,500	195,000	0	688,200
32	Tepelene	171	89,900	14,700	28,800	0	133,400
33	Q.S.U.T	2,772	1,640,371	270,000	3,240,464	0	5,150,835
34	Mat.nr1	378	214,328	35,161	184,000	0	433,489
35	Mat.nr.2	285	178,500	29,300	139,000	0	346,800
36	Sanatoriumi	334	182,600	30,000	207,000	0	419,600
37	Tropoje	163	85,300	14,000	34,000	0	133,300
38	Vlore	584	315,100	51,600	169,686	0	536,386
	Rezerve e pashperndare					0	100,869
	TOTALI	11,872	6,641,704	1,089,311	6,227,336	0	14,059,220



VENDIM
Nr. 12, datë 16.1.2013

**PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK TË DISA
MJEDISEVE NË PËRDORIM TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK DHE
KALIMIN NË PËRDORIM TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK TË DISA
MJEDISEVE TË NDËRTESES (GODINËS) SË ISH-INIMA-S**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në përdorim të Agjencisë së Prokurimit Publik, të disa mjediseve në administrim të saj, të cilat janë në përdorim të Komisionit të Prokurimit Publik, konkretisht, kati i parë teknik, në ndërtesën e Ministrisë së Financave, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Kalimin në përdorim të Komisionit të Prokurimit Publik të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) së ish-INIMA-s, të cilat kanë qenë në përdorim nga Avokati i Prokurimeve, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Avokati i Prokurimeve për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha



PRERJA GJATESORE
Shkalla 1:100


KESHILLI I MINISTRAVE AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK			
OBJEKTI:		RIKONSTRUKSIONI I ZYRAVE TE ADMINISTRATES TE A.P.P- se	Plote Nr A-03 data Dytetor 200
"RAGNOI" Sh.p.k		GRUPI I PROJEKTIMIT	
EMERTIMI I FLETES:		KRYETAR GRUPI	Aliaqeh KERPI
		ARKITEKT	Ferdinand MIMO
PRERJJA GJATESORE		AS. ARKITEKT	Cerit SHAMETAJ
		KONSTRUKTOR	Anesti VASILI
SHKALLA	DISKETA/FILE	INST. H/SANITAR	Kujtim CELA
1:100		INST. ELEKTRIK	Enjro BENCA
FAZA:		INST. TERMIK	Kujtim CELA
ARKITEKTURE P.Z.		PREVENTIVUES	Robert SHYTI





Shtojca 1 / 3

Planimetria e Katit te Pare





VENDIM
Nr. 17, datë 9.1.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIKIM TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV
TIRANA 2, NËNSTACIONI 110 KV KASHAR-SELITË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV, Tirana 2, nënstacioni 110 kV Kashar-Selitë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të “Operatorit të Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme të shpronësimit prej 2 206 (dy mijë e dyqind e gjashtë) m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 725 316 (shtatëqind e njëzet e pesë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh.

4. Fondi prej 725 316 (shtatëqind e njëzet e pesë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga fondet e “Operatorit të Sistemit të Transmetimit” sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 1 327 000 (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë) lekë, të përballohet nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., si subjekt që garanton shpenzimet procedurale të këtij shpronësimi.

6. Shpronësimi të fillojë më 10 janar 2013 dhe të përfundojë brenda muajit mars 2013.

7. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999.

8. Punimet për ndërtimin e linjës 110 kV, Tirana 2, nënstacioni 110 kV Kashar-Selitë të përfundojnë brenda muajit dhjetor 2013.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONAREVE									
Nr i shtylles	Emri mbiemri	Nr. Kadastra I	Nr. pasurise	Lloji i pasurise	Siperfaqe shtylle	Cmimi lek/m2	Vlera ne leke	Fshati	Shenime per pronesine
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	Reshat Sorra Ramiz Sorra	2105	119/2 119/3	are	44	415	18077	Kashar	pronesi me certifikate
2	Agim Dema	2105	33/6	are	50	415	20756	Kashar	pronesi me certifikate
3	Pretendim pronesie	2105	79/1	kullote	55	180	9846	Kashar	ska informacion
4	Pretendim pronesie	2105	81/12,81/14	are	58	415	23970	Kashar	ska informacion
5	Pretendim pronesie	2105	105	pyll	59	52	3082	Kashar	ska informacion
6	Besim Dervishi Pretendim prone	2105	93/10 260/1	are	42	415	17388	Kashar	Certifikate ska informacion
7	Pretendim pronesie	2105	271/1	pyll	44	52	2265	Kashar	ska informacion
8	Pretendim pronesie	2105	330/31	are	58	415	23970	Kashar	ska informacion
10	Pretendim pronesie	2105	568/1	are	44	415	18077	Kashar	ska informacion
11	Pretendim pronesie	3865	568/17,568/18	are	58	483	27898	Yrshek	ska informacion
12	Pretendim pronesie	3865	552	are	59	483	28630	Yrshek	ska informacion
13	Pretendim pronesie	3865	327	are	50	483	24157	Yrshek	ska informacion
14	Pretendim pronesie	3865	327	are	58	483	27898	Yrshek	ska informacion
15	Pretendim pronesie	3865	327	are	44	483	21039	Yrshek	ska informacion
16	Sadik Berziu	2679	288	pemtore are	68	365	24884	Mezez	Certifikate
17	Pretendim pronesie	2679	287	are	39	365	14056	Mezez	ska informacion
19	Pretendim pronesie	2679	2/12	are	39	365	14056	Mezez	ska informacion
shuma				966	shuma				320052



LISTA E PRONAREVE									
Nr i shtylles	Emri mbiemri	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Lloji i pasurise	Siperfaqe shtylle	Cmimi lek/m2	Vlera ne leke	Lloji kultures bujqesore	Shenime per pronesine
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	Reshat Sorra Ramiz Sorra	2105	119/2,119/3	are	41	415	16998	Kashar	pronesi pa certificate
2	Agim Dema	2105	33/6	are	53	415	22115	Kashar	pronesi me certificate
3	Pretendim pronesie	2105	79/1	kullote	56	180	10125	Kashar	ska informacion
4	Pretendim pronesie	2105	81/12, 81/14	are	56	415	23344	Kashar	ska informacion
5	Pretendim pronesie	2105	240, 241	are	59	415	24605	Kashar	ska informacion
6	Pretendim pronesie	2105	260/1	are	45	415	18629	Kashar	ska informacion
7	Pretendim pronesie	2105	271/1	pyll	41	52	2130	Kashar	ska informacion
8	Jemin Xhaferi Pretendim pronesie	2105	330/18 , 330/19,31	are	37	415	15442	Kashar	pronesi me certificate pretendim pronesie
10	Ismail Aluku	2105	568/3	are	60	415	24862	Kashar	pronesi me certificate
11	Pretendim pronesie	2105	552 567/1	are	45	415	18629	Kashar	ska informacion
12	Pretendim pronesie	2105	558/2	are	61	415	25249	Kashar	ska informacion
13	Ramazan Xhaferi Sali Xhaferi	3865	557/1,2	are	40	415	16471	Kashar	pronesi me certificate
14	Pretendim pronesie	1867	562/2	are	46	569	26311	Gropaj	ska informacion
15	Pretendim pronesie	3866	368/13/1	are	56	297	16706	Yzberish	ska informacion
16	Pretendim pronesie	3866	116/9,1162/2	are	56	297	16706	Yzberish	ska informacion
17	Sherif Qerim Sorra	3866	121/1	are	56	297	16706	Yzberish	pronesi me certificate
18	Pretendim pronesie	3866	123/8	are	56	297	16706	Yzberish	ska informacion
19	Pretendim pronesie	3866	123/27	are	81	297	24057	Yzberish	ska informacion
20	Pretendim pronesie	3866	198/24	are	82	297	24325	Yzberish	ska informacion
21	Pretendim pronesie	3866	363,364	are	45	297	13492	Yzberish	ska informacion
22	Pretendim pronesie	3866	304/9/1,304/9	are	53	297	15827	Yzberish	ska informacion
23	Pretendim pronesie	3866	302/9	are	53	297	15827	Yzberish	ska informacion

1240

405264

VENDIM

Nr. 18, datë 9.1.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 707, DATË 25.8.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 400 KV, TIRANË – PODGORICË, QARKU TIRANË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 707, datë 25.8.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe totale prej 9372.35 (nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy pikë tridhjetë e pesë) m², tokë bujqësore, shtëpi, arë dhe ullishte, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 139 053 152 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Fondi prej 139 053 152 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh të përballohet nga fondet e OST sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



N/r	OBJEKTI	Pronesia											Shenime	
		Emri	Atesia	Mbiemri	Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Nr i shtylles	Sasia per shpronесim definitiv m2	cmimi shijle ZRPPlek/ m2	Vlera e kompesimit	Vlera totale e kompesimit ne leke		Adresa e Pronarit
1	LTL 400	Arben	Xhemal	Mesiti	shtepi	2066	40/79	301-302	17	30,800.0	523600.0	523600.0	Kamez	me certificate pronesie
2	LTL 401	Eshref	Gallip	Baloshi	shtepi	2372	240/39	311-312	4	30800.0	123200.0	123200.0	Kamez	me certificate pronesie
Totali									21.0		646 800			

VENDIM
Nr. 20, datë 9.1.2013**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS LABINOT - MAL TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Labinot - Mal të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Labinot - Mal të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr. 456, datë 6.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Labinot - Mal, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Labinot - Mal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Labinot-Mal-Elbasan

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
668-681	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
682-688	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
779-813	Prona që përdoren për shërbime funerale	Në pronësi
707-711,715,720,732-738,743-744,747-750,752,766-778	Prona që përdoren për infrastrukturë dhe shërbime publike (troje)	Në përdorim
1086-1087,1091,1092,1096-1097,1101-1102,1106-1107,1111-1112,1118-1119,1121,1124-1125,1129-1130	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
1088-1090,1093-1095,1098-1100,1103-1105,1108-1110,1113-1115-1117,1120,1122-1123,1126-1128,1131-1134	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
814-1077	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
712-714,716-719,721-731,739-742,745-746,751,753-765	Prona që përdoren për infrastrukturë dhe shërbime publike (sheshe)	Në pronësi
689-697	Prona që përdoren për zhvillim ekonomik	Në pronësi
661-667	Prona që përdoren për programe administrative	Në pronësi



VENDIM
Nr. 21, datë 9.1.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË RUBIK TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Rubik, të qarkut të Lezhës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1327 (një mijë e treqind e njëzet e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Rubik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Rubik

Lidhje 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1 (Pa ndërtesën private)	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
2 – 36 (të mos transferohet pjesa private e pronës nr.2.)	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
37 – 44	Prona që përdoren për realizimin e programeve të shëndetit publik.	Në pronësi
45 – 47	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive.	Në pronësi
48	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive në fushën e shërbimeve sociale.	Në pronësi
53 – 55	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehim dhe mbrojtje civile.	Në pronësi
56,189 – 199,201 – 203	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
204 - 212	Varrezat publike.	Në pronësi
213-219,229-233,237-244,246-247,251-255,257,259-466,468-491,497-530,532-543,545- 548, 1272-1322,1326-1327	Infrastrukturë (Sheshe, lulishte dhe shërbime publike.)	Në pronësi
467,493 – 496,531,1325	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
1131-1132,1136-1137,1141-1143,1147-1148,1151,1155, 1159-1160,1164-1166,1170-1172,1175,1178-1180,1184, 1185	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
1133-1135,1138-1140,1144-1146,1149-1150,1152-1154, 1156-1158,1161-1163,1167-1169,1173-1174,1176,1177, 1181-1183,1186,1187,1255-1271	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
1229-1254,1323,1324	Infrastrukturë (Rrugë vendore).	Në pronësi



VENDIM
Nr. 22, datë 9.1.2013

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 370, DATË 15.9.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN E MISIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË
SELISË SË NATO-S, BRUKSEL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 15 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2/1 shtohet një nënndarje, me këtë përmbajtje:

“- 3 (tre) këshilltarë për politikën e mbrojtjes, civilë, të barasvlershëm me gradën kolonel.”.

b) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2 Këshilltarët për politikën e mbrojtjes janë personel i Ministrisë së Mbrojtjes dhe trajtohen si të tillë edhe pas përfundimit të shërbimit në Përfaqësinë Ushtarake, pranë Përfaqësisë së Përhershme të Republikës së Shqipërisë në NATO, Bruksel. Me përfundimin e shërbimit, këshilltarët kthehen në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barasvlershëm me të.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 23, datë 9.1.2013

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PRAKTIKANTËVE PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS
PROFESIONALE, ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR PERIUDHAT
1 JANAR - 15 QERSHOR 2013 DHE 15 SHTATOR - 31 DHJETOR 2013, PËR MINISTRINË
E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 11 të ligjit nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2012-2013, për periudhat 1 janar - 15 qershor 2013 dhe 15 shtator - 31 dhjetor 2013, të jetë 1 500 veta.

2. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, sipas drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore, dhe afati kohor i kontraktimit të punonjësve jepet sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Praktikantët, gjatë periudhës së kryerjes së praktikës profesionale, përfitojnë nga punëdhënësi, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7%, të përlogaritur mbi pagën minimale 21 000 (njëzet e një mijë) lekë, miratuar me vendimin nr. 445, datë 11.7.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

4. Efektet financiare për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për vitin 2013, në shumën 47 344 500 (dyzet e shtatë milionë e treqind e dyzet e katër mijë e pesëqind) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në buxhetin e vitit 2013.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Tabela nr. 1

Kodi i institucionit	Emërtimi i institucionit arsimor	Punonjës me kontratë të përkohshme për periudhën	Punonjës me kontratë të përkohshme për periudhën
1011002	Drejtoria arsimore Rajonale	59	59
1011006	Drejtoria arsimore Rajonale	43	43
1011007	Drejtoria arsimore Rajonale	83	83
1011008	Drejtoria arsimore Rajonale	105	105
1011009	Drejtoria arsimore Rajonale	83	83
1011011	Drejtoria arsimore Rajonale	24	24
1011015	Drejtoria arsimore Rajonale	69	69
1011018	Drejtoria arsimore Rajonale	37	37
1011020	Drejtoria arsimore Rajonale	37	37
1011033	Drejtoria arsimore Rajonale	88	88
1011035	Drejtoria arsimore e Qytetit	153	153
1011036	Drejtoria arsimore e Qarkut	61	61
1011038	Drejtoria arsimore Rajonale	75	75
1011088	Zyra arsimore Kuçovë	16	16
1011089	Zyra arsimore Skrapar	15	15
1011090	Zyra arsimore Bulqizë	18	18
1011092	Zyra arsimore Mat	32	32
1011096	Zyra arsimore Krujë	30	30
1011100	Zyra arsimore Gramsh	22	22



1011101	Zyra arsimore Librazhd	39	39
1011102	Zyra arsimore Peqin	15	15
1011105	Zyra arsimore Lushnjë	66	66
1011106	Zyra arsimore Mallakastër	17	17
1011109	Zyra arsimore Përmet	14	14
1011110	Zyra arsimore Tepelenë	21	21
1011111	Zyra arsimore Devoll	15	15
1011112	Zyra arsimore Kolonjë	9	9
1011117	Zyra arsimore Pogradec	37	37
1011118	Zyra arsimore Has	10	10
1011120	Zyra arsimore Tropojë	18	18
1011121	Zyra arsimore Kurbin	27	27
1011123	Zyra arsimore Mirditë	18	18
1011124	Zyra arsimore Malësia e Madhe	20	20
1011125	Zyra arsimore Pukë	18	18
1011130	Zyra arsimore Kavajë	36	36
1011132	Zyra arsimore Delvinë	8	8
1011133	Zyra arsimore Sarandë	16	16
1011159	Zyra arsimore Kamëz	46	46
		Totali 1500	1500

VENDIM

Nr. 24, datë 9.1.2013

PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË, TË DOKTORATËS, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2012-2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve të ciklit të tretë, doktoratë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2012-2013, gjithsej 1305, të ndara si më poshtë vijon:

- a) për kandidatët brenda territorit të vendit 1141;
- b) për kandidatët nga trojet jashtë kufijve të vendit 154;
- c) për shtetasit e huaj 10.

2. Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit, të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në kolonën D të tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kuotat e pranimit për kandidatët nga trojet jashtë kufijve të vendit, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në kolonën E të tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë,

administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe, si dhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nga persona të interesuar.

5. Tarifa e shkollimit për programet e studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 216 320 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet) lekë. Tarifa e shkollimit paguhet në këste, të përcaktuara nga institucioni publik i arsimit të lartë.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i secilit institucion publik të arsimit të lartë, pa efekte buxhetore shtesë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



**TABELA Nr.1 KUOTAT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË DOKTORATËS, PËR VITIN
AKADEMIK 2012-2013**

A	B	C	D	E	F
UNIVERSITETI	ID PROGR AMI	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Kuota për kandidatët brenda territorit të vendit	Kuota për kandidatët nga trojet jashtë kufijve të vendit	KUOTA TOTALE
Universiteti i Tiranës	1	Biologji e Ruajtjes	10	2	12
Universiteti i Tiranës	2	Biologji Molekulare	10	2	12
Universiteti i Tiranës	3	Fizikë	8	2	10
Universiteti i Tiranës	4	Bioteknologji Bimore	10	2	12
Universiteti i Tiranës	5	Elektrokimi e Zbatuar dhe Dukuritë Sipërfaqësore	6	2	8
Universiteti i Tiranës	6	Analiza Kimike e Lëndës dhe Mjedisit	6	2	8
Universiteti i Tiranës	7	Teknologjia dhe Mikrobiologjia e Ushqimeve dhe Vlerësimi i Sigurisë dhe Cilësisë	5	2	7
Universiteti i Tiranës	8	Proceset e Trajtimit Kimik të Lëndëve të Para Natyrore dhe të Mbeturinave Industriale e Urbane	6	2	8
Universiteti i Tiranës	9	Analizë dhe Algjebër	10	2	12
Universiteti i Tiranës	10	Metodat Probabilitare, Statistike dhe Metodat e Analizës Numerike	10	2	12
Universiteti i Tiranës	11	Informatikë	12	3	15
Universiteti i Tiranës	12	Shkenca Gjuhësore	35	5	40
Universiteti i Tiranës	13	Letërsi Botërore	18	2	20
Universiteti i Tiranës	14	Kërkime Gjuhësore	25	5	30
Universiteti i Tiranës	15	Studime Letrare	22	3	25
Universiteti i Tiranës	16	Histori	20	5	25
Universiteti i Tiranës	17	Gjeografi	28	2	30
Universiteti i Tiranës	18	Histori me drejtim në Arkeologji	8	2	10
Universiteti i Tiranës	19	Histori me drejtim në Trashëgimi Kulturore	8	2	10
Universiteti i Tiranës	20	Histori me drejtim në Marrëdhënie ndërkombëtare	23	2	25
Universiteti i Tiranës	21	Pedagogji	14	1	15
Universiteti i Tiranës	22	Psikologji	14	1	15
Universiteti i Tiranës	23	Filozofi	9	1	10
Universiteti i Tiranës	24	Punë Sociale	14	1	15
Universiteti i Tiranës	25	Sociologji	9	1	10
Universiteti i Tiranës	26	Shkenca Politike	14	1	15
Universiteti i Tiranës	27	Shkenca Juridike Civile	27	3	30
Universiteti i Tiranës	28	Shkenca Penale	27	3	30
Universiteti i Tiranës	29	E Drejta Publike	27	3	30
Universiteti i Tiranës	30	Ekonomiks	14	1	15
Universiteti i Tiranës	31	Menaxhim	14	1	15
Universiteti i Tiranës	32	Marketing	14	1	15
Universiteti i Tiranës	33	Metodat Sasiore dhe të Informacionit	9	1	10
Universiteti i Tiranës	34	Financë	14	1	15
Universiteti i Tiranës	35	Kontabilitet	14	1	15
Universiteti i Tiranës	36	Kërkime Operacionale	14	1	15
Universiteti i Tiranës	37	Statistika	14	1	15
Universiteti i Tiranës	38	Legjislacion dhe Institucionet e BE-së	13	2	15
Universiteti i Tiranës	39	Politika dhe Qeverisja në Europë	13	2	15
Universiteti i Tiranës	40	Diplomacia dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare të BE	13	2	15
Universiteti i Tiranës	41	Sëmundje kirurgjikale	19	3	22
Universiteti i Tiranës	42	Sëmundjet e Brendshme	18	2	20
Universiteti i Tiranës	43	Mjeku i Familjes	5		5
Universiteti i Tiranës	44	Stomatologji	11	1	12
Universiteti i Tiranës	45	Studime të thelluara të aspekteve epidemiologjike diagnostike dhe terapeutike të sëmundjeve të lëkurës	13	1	14
Universiteti i Tiranës	46	Studime në Obstetrikë Gjinekologji	16	1	17
Universiteti i Tiranës	47	Studime të thelluara dhe kërkime në otorinolaringologji	4		4
	48	Sëmundjet e syrit	4		4
Universiteti i Tiranës	49	Imazheri	7		7

Universiteti i Tiranës	50	Lëndët Biomjekësore-Eksperimentale	9	1	10
Universiteti i Tiranës	51	Kardiokirurgji	7	1	8
Universiteti i Tiranës	52	Studime në Neuroshkencë	10	1	11
Universiteti i Tiranës	53	Shkenca Farmaceutike	13	3	16
Universiteti i Tiranës	54	Morfologji Klinike	14	1	15
Universiteti i Tiranës	55	Mjekësi Laboratorike	9	1	10
Universiteti i Tiranës	56	Pediatri	10	1	11
Universiteti i Tiranës	57	Shëndet Publik	14	2	16
Universiteti i Tiranës	58	Studime të Thëlluara në Kardiologji	2		2
Universiteti i Tiranës	59	Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore	5	5	10
Universiteti Politeknik i Tiranës	60	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	14	1	15
Universiteti Politeknik i Tiranës	61	Inxhinieri Ndërtimi	12	2	14
Universiteti Politeknik i Tiranës	62	Arkitekturë - Urbanistikë	12	2	14
Universiteti Politeknik i Tiranës	63	Gjeodezi	12	2	14
Universiteti Politeknik i Tiranës	64	Gjeoshkencat, Burimet dhe Mjedisi	12	1	13
Universiteti Politeknik i Tiranës	65	Inxhinieri Matematike	8	2	10
Universiteti Politeknik i Tiranës	66	Inxhinieri Fizike	8	2	10
Universiteti Politeknik i Tiranës	67	Inxhinieri Mekanike	10	1	11
Universiteti Bujqësor i Tiranës	68	Bujqësia dhe Mjedisi, me drejtim në Shkencat Agronomike	10	1	11
Universiteti Bujqësor i Tiranës	69	Bujqësia dhe Mjedisi, me drejtim në Shkencat e Prodhimit Shtazor	10	1	11
Universiteti Bujqësor i Tiranës	70	Bujqësia dhe Mjedisi, me drejtim në Shkencat e Hortikulturës	10	1	11
Universiteti Bujqësor i Tiranës	71	Bujqësia dhe Mjedisi, me drejtim në Shkencat Mjedisore	10	1	11
Universiteti Bujqësor i Tiranës	72	Bujqësia dhe Mjedisi, me drejtim në Shkencat e Mbrojtjes së Bimëve	10	1	11
Universiteti Bujqësor i Tiranës	73	Ekonomi dhe Agrobiznes me drejtim në Drejtim Agrobiznesi	15	1	16
Universiteti Bujqësor i Tiranës	74	Ekonomi dhe Agrobiznes me drejtim në Ekonomi dhe Politikë Agrare	15	1	16
Universiteti Bujqësor i Tiranës	75	Ekonomi dhe Agrobiznes me drejtim në Financë-Kontabilitet	15	1	16
Universiteti Bujqësor i Tiranës	76	Shkencat dhe Bioteknologjia Ushqimore	10	1	11
Universiteti Bujqësor i Tiranës	77	Shkencat pyjore me drejtim në Qeverisja e Qendrueshme e Burimeve Pyjore dhe Kullosore	10	1	11
Universiteti Bujqësor i Tiranës	78	Shkencat pyjore me drejtim në Teknologjia e Drurit	9	1	10
Universiteti Bujqësor i Tiranës	79	Mjekësi Veterinare	14	1	15
Qendra e Studimeve Albanologjike	80	Shkencat Gjuhësore	13	2	15
Qendra e Studimeve Albanologjike	81	Shkencat Etnologjike dhe Folklor	13	2	15
Qendra e Studimeve Albanologjike	82	Shkencat Historike	15	3	18
Qendra e Studimeve Albanologjike	83	Shkencat Arkeologjike	10	2	12
Qendra e Studimeve Albanologjike	84	Shkencat Letrare	15	2	17
Qendra e Studimeve Albanologjike	85	Historia e Arteve Shqiptare	10	2	12
Universiteti "A. Moisiu" Durrës	86	Shkencat Ekonomike	10	2	12
Universiteti "I. Qemali" Vlorë	87	Matematikë	13	2	15
Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan	88	Albanologji në profilin "Histori"	9	1	10
Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan	89	Albanologji në profilin "Gjuhësi"	9	1	10
Universiteti "L. Gurakuqi" Shkodër	90	Gjuhë Shqipe	8	2	10
Universiteti "F.S.Noli" Korçë	91	Hortikulturë e Qëndrueshme	9	1	10
Universiteti i Sporteve të Tiranës	92	Shkenca Sportive	10	3	13
		TOTALI	1141	154	1295



VENDIM
Nr. 25, datë 9.1.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
TË BASHKISË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të pronave të paluajtshme shtetërore, me nr. pasurie 8/637, me sipërfaqe 23 (njëzet e tre) m², dhe 8/638, me sipërfaqe 2 400 (dy mijë e katërqind) m², të ndodhura në zonën kadastrale 8270, indeks harte TR – U, V- 9,10, rruga “Anton Ashta”, pjesë e pasurisë me nr. 8/72, me nr. rendor 264, në listën që i bashkëlidhet vendimit nr. 834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrim të Bashkisë Tiranë, të qarkut të Tiranës”.

2. Prona e paluajtshme shtetërore me nr. rendor 276 “Cirku i Tiranës”, në juridiksion të Bashkisë Tiranë, e kaluar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas vendimit nr. 458, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave, t’i kalojë në pronësi Bashkisë Tiranë.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Bashkia Tiranë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha





VENDIM
Nr. 26, datë 9.1.2013

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE
DHE TË KANDIDATIT FITUES PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË “HEC BISTRICA 1
DHE BISTRICA 2” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 7 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar dhe të neneve 3, 5 e 8 të ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “HEC Ulëz - Shkopet” sh.a. “HEC Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. dhe përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “HEC Ulëz - Shkopet” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.” me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave, paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për privatizimin e shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e ofertës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., si fituese për blerjen e 100 për qind të aksioneve të shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., me vlerë 52 000 000 (pesëdhjetë e dy milionë) euro.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të negociojë dhe të nënshkruajë kontratën me kandidatin fitues, shoqërinë “Kurum International” sh.a.

4. Ngarkohet Ministria e Financave, që, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të bëjë identifikimin e vlerës së TVSH-së së rimbursueshme për shoqërinë “Kurum International” sh.a., përpara firmosjes së kontratës.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE**

RAPORT

**PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË
“HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2 SHA”.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për privatizimin e shoqërisë HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2 SHA, e krijuar me Urdhrin Nr.782 datë 18.12.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për privatizimin e shoqërisë HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2 SHA”, bazuar në Raportin e Konsulentit për vlerësimin e ofertave për privatizimin e Shoqërisë HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2 SHA dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.676, datë 3.10.2012 “Për një ndryshim në Vendimin Nr.152, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë për shitjen e 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare “HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2”, (referuar si VKM Nr. 676) paraqet Raportin Përfundimtar të Vlerësimit të Ofertave .

Në procesin e tenderit të mbajtur më 21 Dhjetor 2012, ora 11.00 am pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, u morën ofertat e mëposhtme për privatizimin e HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a., të renditura sipas vlerës së tyre :

1. Kurum International Sh.A	52.0 mil EURO
2. Energolinija LLC	44.8 mil EURO
3. Konsorcium “Aga Sh.a”- “Tirana International Development Shpk” dhe “ETS shpk	37.1 mil EURO
4. Konsorcium: ERPA Investment Shpk dhe K&J shpk	35.1 mil EURO
5. Georgian American Alloys, Inc.	30.3 mil EURO
6. Konsorcium: -TRE SpA, Novapower-Camuna Idroelecttricha SpA	27.5 mil EURO
7. Calik Enerji dhe Adacami Enerji”	19.3 mil EURO

Vlerësimi paraprak i dokumentacionit tregoi se shumica e investitorëve, në dukje nuk përmbushnin kriteret e kualifikimi dhe/ose dokumentacioni i paraqitur nuk përputhej me kërkesat formale dhe të përmbajtjes së ofertës teknike e financiare sipas Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit.

Për pasojë, më datë 4 Janar 2013, Koordinator Projektit pranë METE-s i dërgoi investitorëve një kërkesë për sqarime mbi dokumentacionin e mangët/parregullt. Në vijim të kësaj kërkesë, investitorët vijues dërguan sqarimet e kërkuara: Konsorciumi AGNA, Energolinija, Konsorciumi ERPA Investment dhe Konsorciumi TRE.



Për më tepër, Konsorciumi Calik Enerji ka dërguar një kërkesë për kthimin e garancisë së ofertës së bërë prej tij.

Në bazë të sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson sa vijon:

1. Kurum International Sh.A (Shqiperi)

Investitori plotëson kërkesat e kualifikimit, dhe oferta nga ana formale dhe materiale është e plotë. Gjithsesi, në dokumentacionin e ofertës financiare, investitori bashkëlidh një shkresë sipas të cilës shprehet se: *“Oferta jonë është subjekt dhe merr në konsideratë të drejtat financiare të pagueshme, që Shteti Shqiptar ka në formën e TVSH-së së verifikueshme për t’u rimbursuar ndaj ofertuesit, ose ndonjë të tillë (të drejtë) të njohur nga Autoriteti Kontraktues dhe do të përfshihet në negociimin e kontratës”*

Formulimi i ofertës lë të kuptohet se implikon kërkesën për të kompensuar pjesë të çmimit të shitjes së ofruar, me shumën e TVSH-së së rimbursueshme. Ndërkohë që kjo kërkesë është qartësisht jashtë objektit të dokumenteve të privatizimit; e drejta për të kërkuar rimbursimin e TVSH-së, në shumat e konfirmuara nga autoritetet fiskale garantohet sipas ligjit Shqiptar. Në bazë të Procedurave të Tenderimit, ofertat e kushtëzuara nuk pranohen. Gjithsesi, në cilësinë e organit kompetent për miratimin/ndryshimin e Procedurave të Tenderimit, Këshilli i Ministrave mund të vendosë të pranojë ose jo ofertën e Kurum, me të gjitha kushtet e saj.

2. Energolinija LLC (Bosnjë - Hercegovinë)

Oferta e investitorit paraqet dokumentacion të pamjaftueshëm për kualifikimin e tij dhe garancia e ofertës nuk është në përputhje me kërkesat tenderit, pasi mungon Garancia Bankare (Sigurimi i Ofertës është lëshuar si garanci e korporatës).

Rrjedhimisht, në bazë të Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit, oferta duhet të skualifikohet.

3. Konsorcium “Agha Sh.a”- “Tirana International Development Shpk” dhe “ETS shpk “(Shqiperi)

Investitori plotëson kërkesat e kualifikimit, dhe oferta nga ana formale dhe materiale është e plotë, me përjashtim të garancisë së ofertës, e cila paraqet një afat vlefshmërie më të shkurtër se afati i kërkuar në Udhëzimet për Ofertuesit. Në vijim të kërkesës për sqarim, ofertuesi është shprehur me shkrim i gatshëm për të zgjatur afatin e vlefshmërisë së garancisë së ofertës, e rrjedhimisht oferta kualifikohet (me kusht që të realizohet zgjatja e afatit të garancisë).

4. Konsorcium: ERPA Investment Shpk dhe K&J shpk (Shqiperi)

Oferta e investitorit paraqet dokumentacion të pamjaftueshëm për kualifikimin e tij, dhe garancia e ofertës nuk është në përputhje me kërkesat tenderit, pasi Dokumenti i Sigurimit të Ofertës nuk identifikon METE si përfituese dhe teksti i saj nuk është në përputhje me formularin e Sigurimit të Ofertës.

Rrjedhimisht, në bazë të Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit, oferta duhet të skualifikohet.

5. Georgian American Alloys, Inc. (USA)

Oferta e investitorit paraqet dokumentacion të pamjaftueshëm për kualifikimin e tij. Ofertuesi nuk ka paraqitur garancinë e ofertës dhe kopjen e sigluar të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve. Rrjedhimisht, në bazë të Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit, oferta duhet të skualifikohet.

6. Konsorcium: TRE SpA-Itali, Novapower-Camuna Idroelettrica SpA- Itali

Oferta e investitorit paraqet mangësi të theksuara, përmban një sërë kushtesh dhe shprehet se nuk është detyruese për investitorin. Ofertuesi nuk ka paraqitur garancinë e ofertës. Rrjedhimisht, në bazë të Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit, oferta duhet të skualifikohet.

7. Konsorcium: “ÇALIK ENERJË DHE ADACAMI ENERJË” (Turqi)

Garancia e ofertës nuk është në përputhje me kërkesat tenderit, pasi Sigurimi i Ofertës nuk është konfirmuar nga Banka Shqiptare - përmban formulimin mbi konfirmimin nga BKT të nënshkruesve të autorizuar të METE. Ofertuesi nuk i është përgjigjur kërkesës për sqarime brenda afatit të kërkuar, por ka kërkuar kthimin e Garancisë së Ofertës, çka nuk është në përputhje me Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit. Rrjedhimisht, në bazë të Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit, oferta duhet të skualifikohet.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

Z.Sokol Dervishaj	kryetar
Z.Alfred Rushaj	anëtar
Z.Dael Dervishi	anëtar
Z.Majlind Lazimi	anëtar
Z.Genti Minarolli	anëtar
Z.Zamir Stefani Moçka	anëtar
Z.Fatmir Isufaj	anëtar
Z.Agim Bregasi	anëtar
Znj.Dhurata Hoxha	anëtare
Z.Petrit Gjoni	anëtar
Z.Eduart Elezi	anëtar
Znj.Doris Çarçani	anëtar
Z.Gazment Bardhi	anëtar



VENDIM
Nr. 27, datë 9.1.2013

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE
DHE TË KANDIDATIT FITUES PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË
“HEC ULËZ - SHKOPET” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 7 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar dhe të neneve 3, 5 e 8 të ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “HEC Ulëz - Shkopet” sh.a., “HEC Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. dhe përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “HEC Ulëz - Shkopet” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave, paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për privatizimin e shoqërisë “HEC Ulëz - Shkopet” sh.a., i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e ofertës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., si fituese, për blerjen e 100 për qind të aksioneve të shoqërisë “HEC Ulëz - Shkopet” sh.a., me vlerë 57 500 000 (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë) euro.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të negociojë dhe të nënshkruajë kontratën me kandidatin fitues, shoqërinë “Kurum International” sh.a.

4. Ngarkohet Ministria e Financave, që, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të bëjë identifikimin e vlerës së TVSH-së së rimbursueshme për shoqërinë “Kurum International” sh.a., përpara nënshkrimit të kontratës.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE**

RAPORT

**PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË
“HEC ULEZ SHKOPET SHA”.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për privatizimin e shoqërisë “HEC ULEZ SHKOPET SHA”, e krijuar me Urdhërin Nr.783 datë 18.12.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për privatizimin e shoqërisë “HEC Ulez Shkopet Sh.A”, bazuar në Raportin e Konsulentit për vlerësimin e ofertave për privatizimin e Shoqërisë HEC Ulez Shkopet Sh.A dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.677, datë 3.10.2012 “Për një ndryshim në Vendimin Nr.153, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë për shitjen e 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare “HEC Ules Shkopet SHA”, (referuar si VKM Nr. 677) paraqet Raportin Përfundimtar të Vlerësimit të Ofertave .

Në procesin e tenderit të mbajtur më 21 Dhjetor 2012, ora 12.00 am pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, u morën ofertat e mëposhtme për privatizimin e Shoqërisë “HEC Ules Shkopet SHA” të renditura sipas vlerës financiare:

1. Kurum International Sh.A	57.5 milion EURO
2. Energolinija LLC	31.9 milion EURO
3. Georgian American Alloys, Inc	26.5 milion EURO
4. Konsorciumi Calik Enerji dhe Adacami Enerji	15.8 milion EURO

Vlerësimi paraprak i dokumentacionit tregoi se shumica e investitorëve, në dukje nuk përmbushnin kriteret e kualifikimi dhe/ose dokumentacioni i paraqitur nuk përputhej me kërkesat formale dhe të përmbajtjes së ofertës teknike e financiare sipas Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit.

Për pasojë, më datë 4 Janar 2013, Koordinatori Projektit pranë METE-s i dërgoi investitorëve një kërkesë për sqarime mbi dokumentacionin e mangët/parregullt. Në vijim të kësaj kërkesë Energolinija dërgoi sqarimet e kërkuara:

Për më tepër, Konsorciumi Calik Enerji ka dërguar një kërkesë për kthimin e garancisë së ofertës së bërë prej tij.

Në bazë të sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson sa vijon:



1. Kurum International Sh.A (Shqiperi)

Investitori plotëson kërkesat e kualifikimit dhe oferta nga ana formale dhe materiale është e plotë. Gjithsesi, në dokumentacionin e ofertës financiare, investitori bashkëlidh një shkresë sipas të cilës shprehet se: *“Oferta jonë është subjekt dhe merr në konsideratë të drejtat financiare të pagueshme, që Shteti Shqiptar ka në formën e TVSH-së së verifikueshme për t’u rimbursuar ndaj ofertuesit, ose ndonjë të tillë (të drejtë) të njohur nga Autoriteti Kontraktues dhe do të përfshihet në negociimin e kontratës”*

Formulimi i ofertës lë të kuptohet se implikon kërkesën për të kompensuar pjesë të çmimit të shitjes së ofruar, me shumën e TVSH-së së rimbursueshme. Ndërkohë që kjo kërkesë është qartësisht jashtë objektit të dokumenteve të privatizimit; e drejta për të kërkuar rimbursimin e TVSH-së, në shumat e konfirmuara nga autoritetet fiskale garantohet sipas ligjit Shqiptar. Në bazë të Procedurave të Tenderimit, ofertat e kushtëzuara nuk pranohen. Gjithsesi, në cilësinë e organit kompetent për miratimin/ndryshimin e Procedurave të Tenderimit, Këshilli i Ministrave mund të vendosë të pranojë ose jo ofertën e Kurum, me të gjitha kushtet e saj.

2. Energolinija LLC (Bosnjë - Hercegovinë)

Oferta e investitorit paraqet dokumentacion të pamjaftueshëm për kualifikimin e tij dhe garancia e ofertës nuk është në përputhje me kërkesat tenderit, pasi mungon Garancia Bankare (Sigurimi i Ofertës është lëshuar si garanci e korporatës).

Rrjedhimisht, në bazë të Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit, oferta duhet të skualifikohet.

3. Georgian-American Alloys

Oferta e investitorit paraqet dokumentacion të pamjaftueshëm për kualifikimin e tij. Ofertuesi nuk ka paraqitur garancinë e ofertës dhe kopjen e sigluar të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve. Rrjedhimisht, në bazë të Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit, oferta duhet të skualifikohet.

4. Konsorciumi Calik Enerji

Garancia e ofertës nuk është në përputhje me kërkesat tenderit, pasi Sigurimi i Ofertës nuk është konfirmuar nga Banka Shqiptare - përmban formulimin mbi konfirmimin nga BKT të nënshkruesve të autorizuar të METE. Ofertuesi nuk i është përgjigjur kërkesës për sqarime brenda afatit të kërkuar, por ka kërkuar kthimin e Garancisë së Ofertës, çka nuk është në përputhje me Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit. Rrjedhimisht, në bazë të Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit, oferta duhet të skualifikohet.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

Z.Sokol Dervishaj	kryetar
Z.Alfred Rushaj	anëtar
Z.Dael Dervishi	anëtar
Z.Majlind Lazimi	anëtar
Z.Genti Minarolli	anëtar
Z.Zamir Stefani Moçka	anëtar
Z.Fatmir Isufaj	anëtar
Z.Agim Bregasi	anëtar
Znj.Dhurata Hoxha	anëtare
Z.Petrit Gjoni	anëtar
Z.Eduart Elezi	anëtar
Znj.Doris Çarçani	anëtar
Z.Gazment Bardhi	anëtar

URDHËR

Nr. 2/1, datë 8.1.2013

PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizmin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të shkronjës “a” të nenit 6 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Nga verifikimi i regjistrit të përgjithshëm të noterëve, të administruar nga Ministria e Drejtësisë, rezulton se noterja Znj.Natasha Thanas Stefa, e datëlindjes 2.1.1948, e pajisur me licencën nr. 5175, datë 17.10.2000, e cila ushtron verpimtarinë e saj noteriale pranë Bashkisë Kuçovë, ka kbushur moshën 65 vjeç.

PËR KËTO ARSYE,

Mbështetur në shkronjën b të nenit 6 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë“, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noteres znj. Natasha Stefa, anëtare e Dhomës së Noterisë Vlorë, pasi ka mbushur moshën 65 vjeç.
2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit të përbërë nga 5 anëtarë:
 - a) Znj.Odeta Dervishi, inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
 - b) Znj.Rezarta Koçi, inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.



c) Z.Erjon Ndreca, inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

d) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

e) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Vlorë.

3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Vlorë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, noteres Anila Bardhi, e cila plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të interesuarve, për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

4. Nxjerrjen jashtë përdorimit të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Natasha Stefa nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

5. Urdhri t'i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të Shkallës së Parë dhe Apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

UDHËZIM
Nr. 33, datë 21.1.2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 24.9.2012 “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RUAJTJEN E SIGURISË SË TË DHËNAVE PERSONALE TË PËRPUNUARA NGA KONTROLLUESIT E MËDHENJ”

Në mbështetje të shkronjës “f” pika 1 e nenit 31 dhe në bazë të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 21, datë 24.9.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijon:

1. Në titullin e udhëzimit, togfjalëshi “kontrolluesit e mëdhenj” zëvendësohet me “subjektet përpunuese të mëdha”.

2. Në pikën 1, togfjalëshi “teknike dhe organizative” zëvendësohet me “teknike, organizative edhe në lidhje me personelin”.

3. Përmbajtja e shkronjës “a” të pikës 2, ndryshohet si vijon:

“Subjekte përpunuese të mëdha janë kontrolluesit ose përpunuesit, të cilët përpunojnë të dhëna personale në mënyrë elektronike ose manuale, duke shfrytëzuar 6 e më shumë persona për të kryer përpunimin, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të përpunuesve”.

4. Në pikën 4, akti nënligjor i referuar ““Udhëzimin nr. 2, datë 25.2.2010 “Për detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale””, zëvendësohet me ““Udhëzimin nr. 24 , datë 27.12.2012 “Për detyrimet e kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale””.

5. Në pikën 6, togfjalëshi “masave teknike, organizative dhe të sigurisë personale” zëvendësohet me “masave të sigurisë teknike, organizative edhe në lidhje me personelin”.

6. Në pikën 7, togfjalëshi “i jashtëm (person fizik ose juridik)” hiqet nga përmbajtja.
 7. Në pikën 13, fjala “platformës” zëvendësohet me fjalën “shërbimeve”.
 8. Në pikën 14, termi “business continuity plan” hiqet nga përmbajtja.
 9. Në pikën 17, togfjalëshi “masat teknike dhe organizative të nevojshme” zëvendësohet me “masat teknike, organizative edhe në lidhje me personelin”.
 10. Në shkronjën “b” të pikës 20, fjala “dhe personale” zëvendësohet me togfjalëshin “edhe në lidhje me personelin”.
 11. Në paragrafin “i” të shkronjës “c” të pikës 21, fjala “të personelit” zëvendësohet me togfjalëshin “edhe në lidhje me personelin”.
 12. Në shkronjën “c” të pikës 34, fjala “të personelit” zëvendësohet me togfjalëshin “edhe në lidhje me personelin”.
 13. Në pikën 38, togfjalëshi “që sjell dëme për të”, zëvendësohet me “në dëm të personit të kontaktit”.
 14. Përmbajtja e pikës 41 ndryshon si vijon:
“Nëse nuk është e mundur, për arsye objektive, të zbatohet afati i përcaktuar në pikën 40, Komisioneri do të ofrojë një muaj shtesë për subjektin përpunues të të dhënave personale”.
- Ky udhëzim hyn në fuqi në të njëjtën kohë me udhëzimin nr. 21, datë 24.9.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)

UDHËZIM
Nr. 34, datë 21.1.2013

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 22, DATË 24.9.2012 “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RUAJTJEN E SIGURISË SË TË DHËNAVE PERSONALE TË PËRPUNUARA NGA KONTROLLUESIT E VEGJËL”

Në mbështetje të shkronjës “f” pika 1 e nenit 31 dhe në bazë të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 22, datë 24.9.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijon:

1. Në titullin e udhëzimit, togfjalëshi “kontrolluesit e vegjël” zëvendësohet me “subjektet përpunuese të vogla”.
2. Në pikën 1, togfjalëshi “teknike dhe organizative” zëvendësohet me “teknike, organizative edhe në lidhje me personelin”.
3. Përmbajtja e pikës 2, ndryshohet si vijon:
“Subjekte përpunuese të vogla janë kontrolluesit ose përpunuesit, të cilët përpunojnë të dhëna personale në mënyrë elektronike ose manuale, duke shfrytëzuar më pak se 6 persona për të kryer përpunimin, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të përpunuesve”.
4. Në pikën 4, akti nënligjor i referuar ““Udhëzimin nr. 2, datë 25.2.2010 “Për detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale””, zëvendësohet me



“Udhëzimin nr. 24, datë 27.12.2012 “Për detyrimet e kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale””.

5. Në pikën 5, togfjalëshi “teknike dhe organizative” zëvendësohet me “teknike, organizative edhe në lidhje me personelin”.

6. Në pikën 6, pas fjalës “organizative” shtohet togfjalëshi “edhe në lidhje me personelin”.

7. Përmbajtja e paragrafit 2 të shkronjës “a” të pikës 8, ndryshohet si vijon:

“Analiza e riskut kryhet në mënyrë periodike dhe dokumentohet në mënyrë të kuptueshme për praktikën e veprimtarisë së subjekteve përpunuese”.

8. Në pikën 9, data e udhëzimit 21 ndryshohet në “24.9.2012”.

Ky udhëzim hyn në fuqi në të njëjtën kohë me udhëzimin nr. 22, datë 24.9.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 24.1.2013
Doli nga shtypi më 25.1.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 42 lekë